



FOTO: PROJEKTI FATKEQËSITË NUK NJOHIN KUFINJ 2 - AKTIVITETE INFORMATIVE

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe
Mal i Zi - Kosovë 2014- 2020

Gusht 2023

PËRMBAJTTJA

Edicioni i shtatëmbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

»»»	Premiera e Filmit Dokumentar mbi ekoturizmin në territorin e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës në Podgoricë	2
»»»	Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri	3
»»»	Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë	4
»»»	Të reja nga projektet në Thirrjen e III-ë të Programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri	5
»»»	Të reja nga projektet në Thirrjen e III-ë të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë	7
»»»	Promovohet IPA III Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri	10
»»»	Strukturat e Programeve IPA-BNK morën pjesë në Forumin Konsultativ Rajonal të CBIB+.....	10

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbytja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opininionin e GJND -së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



MNE - KOS
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020



Premiera e Filmit Dokumentar mbi ekoturizmin në territorin e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës në Podgoricë

Me datë 18 Maj të vitit 2023, në ambjentet e Shtëpisë së Europës në Podgoricë, Ministria e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, transmetoi premierën e filmit dokumentar të titulluar Promovimi i ekoturizmit në territorin e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës.

Përmes këtij filmi dokumentar pesëmbëdhjetë minutësh, i cili çon shikuesit në një udhëtim nëpër zonën kufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe Malit të Zi e Kosovës, janë prezantuar rezultatet e arritura në kuadër të 8 projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar në këtë zonë.

Duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Fondet Evropiane në Ministrinë e Çështjeve Evropiane, **Bojan Vujović**, tha se përkushtimi i tre strukturave operative, me të gjitha palët e përfshira, mundësoi shfaqjen e rezultateve të rëndësishme në fushën e promovimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Vujović theksoi se "Në kuadër të IPA II Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri deri më tani janë mbështetur 21 projekte me një vlerë totale mbi 7 milionë euro në fushën e turizmit, punësit dhe mbrojtjes së mjedisit me qëllim të përmirësimit të standardit dhe cilësisë së jetës së njerëzve në zonën e programit. Nga ana tjetër, në kuadër të programit me Kosovën janë mbështetur 23 projekte me vlerë totale mbi 7 milionë euro".



Në emër të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës në Shqipëri, iu drejtua të pranishëmve **Kjara Adhami**, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administrimit të Ndhmës Financiare të BE-së, e cila vlerësoi se rezultatet në terren janë të dukshme dhe se bashkëpunimi i përbashkët cilësor ka mundësuar këto rezultate të shkëlqyera.



Trim Berisha, zv. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e administrimit të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës, ka veçuar bashkëpunimin në mes të Malit të Zi dhe Kosovës si shembull të marrëdhënieve të mira fqinjësore. "Në kuadër të këtij programi janë realizuar shumë aktivitete me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës në zonën kufitare të Malit të Zi dhe Kosovës dhe rezultatet e projekteve dëshmojnë vazhdimësinë e avancimit të bashkëpunimit ndërinstitucional të dy vendeve", tha Berisha.



Liselotte Isaksson, zv. Shefe e Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Malin e Zi, shprehu kënaqësinë e saj që BE mbështet zhvillimin e potencialit në sektorin e turizmit të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës.



"Jam shumë kërenar që Bashkimi Evropian mbështeti projekte përmes të cilave fituam produkte të reja dhe inovative në këtë fushë, duke e diversifikuar dhe duke e bërë ofertën turistike më të aksesueshme dhe më tërheqëse për vizitorët." veçoi Isaksson. Filmin dokumentar

Promovimi i Ekoturizmit në Territorin e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës mund ta shikoni duke klikuar [këtu](#).

Pas shfaqjes së filmit, u mbajt një panel diskutimi me përfaqësues nga projektet e financuara nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar rreth temës: Mundësitë e Bashkëpunimit ndërkufitar dhe rëndësia e ekoturizmit dhe turizmit.



Snezhana Zeçeviq nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal për Bjellasicën, Komovi dhe Bjeshkët e Namuna, **Stilian Doraci** nga OJF EuroPartners Development nga Shqipëria dhe **Virtyt Morina** nga Komuna e Pejës nga Kosova biseduan sëbashku me **Nikolla Gjonoviq**, nga Sekretariati i Përbashkët Teknik, mbi arritjet kryesore të projekteve, përvojat nga terreni dhe reagimin dhe vlerësimin e përfuesve final ndaj nismave të shumta. Gjatë panelit u vlerësua se bashkëpunimi ndërkufitar ofron mundësi për ndërhyrje të rëndësishme në komunitetet lokale dhe se ky instrument duhet të përdoret nga të gjithë aktorët.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Prodhuesit e bimëve mjekësore dhe mjaltit morën mbështetje përmes projekteve të BE-së

Në kuadër të projektit *Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit*, përfitues të shumtë janë mbështetur me trajnime mbi menaxhimin dhe përpunimin e bimëve aromatike dhe mjekësore.

Almir Jasaviq nga Plava është një nga prodhuesit e bimëve mjekësore dhe mjaltit që është mbështetur përmes projektit të financuar nga BE. Së fundmi ai mori pjesë në një emision televiziv ku theksoi rëndësinë e mbështetjes së BE-së në projekte të tilla. Shikoni intervistën [këtu](#).

Hartat e lokaliteteve të bimëve aromatike dhe mjekësore janë në dispozicion në internet. Për më shumë informacion vizitoni <https://didc-map-tropoje.al> dhe <https://aromaticmedicine-plants.me>.



Aktivitetet informuese lidhur me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Gjatë muajit qershor në Tivar, Ulqin dhe Budvë u organizuan aktivitete informative mbi temën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, me qëllim të informimit të popullatës së këtyre komunave për rreziqet më të shpeshta dhe masat adekuata me qëllim të parandalimit dhe sanimit të pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në radhë të parë nga përmbytjet dhe zjarret. Eventet informative u organizuan në bashkëpunim me përfaqësuesit e Shërbimit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Tivarit, si dhe të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Në kuadër të aktivitetit, u shpërndanë publikime informuese për tema që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe shpëtimin në rast aksidenti dhe materiale promovuese. Aktivitetet u organizuan në kuadër të projektit *Fatkeqësitë nuk Njohin Kufinj 2* që FORS Montenegro po zbaton në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Shkodër.



Aktivitetet të reja të projektit SOLUTION

Qendra e Kërkimeve Ekotoksikologjike të Malit të Zi, Universiteti i Tiranës si dhe OJF Qendra Gjellbër, në kuadër të projekti *Liçeni i Shkodrës pa Ndotje Kimike-SOLUTION*, vazhdojnë bashkëpunimin në formën e aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të organizatave. Konkretisht, me 14 qershor të vitit 2023 në Shkodër u mbajt punëtorja Rezultatet e testeve biologjike invitro të cilësisë së ujit dhe krahasimi me analizat kimike ku mori pjesë dhe eksperti mjedisor Patrick Reynolds. Ndër temat kryesore që u diskutuan ishin Direktivat Kuadër të Ujit dhe Substancave Prioritare, rezultatet e analizave biologjike në lidhje me analizat kimike dhe analizat kimike të pikave të nxehta të liqenit të Shkodrës. Rezultati i projektit fitoi

shikueshmëri dhe dukshmëri shtesë përmes raportimeve të mediave. Për më shumë detaje kliko [këtu](#) për kronikën e Zërit të Amerikës si dhe [këtu](#) për artikullin e Shtëpisës së Europës së Malit të Zi.



Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për përfituesit

Projekti ACCENT ka vazhduar me aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve edhe gjatë verës. Nga data 28 deri me 31 gusht të vitit janë zhvilluar trajnime rreth Motivimit dhe vetëbesimit të cilat u udhëhoqën nga Aleksandra Angjeliq.



Temat e trajnimit ishin rëndësia e vetëbesimit për sukses, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm për vetëbesimin, dallimi midis vetëbesimit të shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm, shtyllat e vetëbesimit, ndikimi i etiketimit në vetëbesimin, faktorët e motivimit, menaxhimi i prioritetëve, çfarë na demotivon, harta e pikave të forta, ushtrimet dhe tema të tjera të ngjashme.

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Punë të reja në bujqësi

Më 27 korrik në Podgoricë u mbajt konferenca finale e projektit "Krijimi i vendeve të punës në bujqësi". Projekti është implementuar nga Kryeqyteti Podgoricë - Departamenti për Ndërmarrësi dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës - IADK. Gjatë konferencës u theksua se vlera totale e këtij projekti për përfituesit në Mal të Zi dhe Kosovë ka qenë 350 mijë euro, nga të cilat pjesa më e madhe e mjeteve janë ndarë për blerjen e pajisjeve, vlera e të cilave ishte mbi 75 mijë euro.

Me këtë projekt mbi 60 përfitues fituan njohuri të reja dhe morën pajisje për të përmirësuar prodhimin e tyre, mbi 5000 persona u informuan për këtë projekt përmes prezantimit mediatic dhe rreth 30 persona i siguruan vetes një burim të përhershëm të ardhurash dhe rritje të



punësit, ndërsa mbi 250 persona mori pjesë në përmirësimin e njohurive dhe aftësive bujqësore. Në tregun e gjelbër u organizua edhe një panair i suksesshëm i produkteve bujqësore të përdoruesve, ku mbi 1000 vizitorë patën mundësinë të njihen dhe të shijojnë produktet e përdoruesve.



Pjesëmarrësit e konferencës vlerësuan se projekti ka sjellë rezultate të mira dhe se si i tillë mund të jetë model për disa iniciativa të ngjashme në këtë temë në periudhën e ardhshme.

Pajisjet për institucionet shëndetësore

Në kuadër të projektit "CARES 2", partnerët e projektit FORS Mali i Zi dhe ECMI Kosova, vazhduan me aktivitete ndërgjegjëse dhe ekzaminime parandaluese në të dy anët e kufirit. Për më tepër, procedura e prokurimit për pajisjet mjekësore është finalizuar në Kosovë. Pajisjet do të dërgohen në institucionet shëndetësore në Gjakovë, Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan, ndërsa stafi mjekësor do të trajnohet për përdorimin e kësaj

pajisjeje. Gjithashtu, në periudhën e ardhshme pritet që të dërgohen pajisje shtesë në institucionet shëndetësore në Mal të Zi.



Qendrat turistike për një projekt turistik më të mirë në fazën përfundimtare

Projekti "Qendrat turistike për ofertë më të mirë turistike në zonat malore më pak të favorizuara" ka hyrë në fazën përfundimtare të zbatimit. Komuna e Andrijevics ka përfunduar aktivitetet e parapara të projektit, ku janë organizuar trajnime për amvisëritë rurale dhe janë blerë pajisje shtesë për shtëpinë e bjeshkatarëve në Mal të Zi. Shtëpia e bjeshkatarëve *Krivi do* u bë një atraksion turistik dhe pjesë e ofertës turistike e cila po promovohet edhe nga agjencitë turistike. Në Kosovë janë zhvilluar aktivitete të ngjashme dhe kanë përfunduar punimet në shtëpinë e bjeshkatarëve në Bjeshkët e Belegut. Është hapur edhe faqja e re e [SHBA "Shkëlzen Haradinaj"](#) i cili do të menaxhojë shtëpinë e bjeshkatarëve.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Pa kufinj për punë!

Projekti *Pa Kufinj për Punë!* po zbatohet me qëllimin për të përmirësuar përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik të zonave kufitare të Fushë Arrëzitet, Malësisë së Madhe dhe zonës së Cetinës dhe Podgoricës. Ky projekt dy-vjeçar po zbatohet nga një partneritet ndërmjet Kryeqytetit të Vjetër Mbretëror të Cetinës, ProAct Hub, Institutit të Politikave të Qëndrueshme dhe Bashki së Fushë Arrëzitet. Vlera totale e projektit është 428,085.60 euro, me qëllimin për të përmirësuar punësueshmërinë dhe përfshirjen sociale të të rinjve, grave, të papunëve afatgjatë dhe personave me aftësi të kufizuara në sektorët e turizmit rural dhe shërbimeve të kateringut, iniciativave të ekonomisë së gjelbër dhe të qarkullueshme, agrikulturë dhe sipërmarrje gjithëpërfshirëse. Një nga qëllimet specifike të këtij projekti është përmirësimi i konkurrencës së biznesëve ndërkufitare nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për

përdorimin e qëndrueshëm të burimeve lokale, nevojave të tregut dhe prespektivës për punësim të vazhdueshëm dhe vetëpunësim në sektorët e targetuar brënda këtyre zonave.



Partnerët e projektit filluan me zbatimin e aktiviteteve pas nënshkrimit të një Marrëveshje Bashkëpunimi që do të përmirësojë situatën e punësimit të rinisë dhe kategorive të tjera sociale në zonën e targetuar.

Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Mjedisit - JEPA

Komuna e Gucisë dhe Bahskia e Pukës po zbatojnë projektin *Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Mjedisit – JEPA*, me një vlerë totale prej 300,420 euro dhe një kohëzgjatje prej 18 muajsh. Qëllimi i projektit është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në zonën kufitare, reduktimi i ndotjes dhe rritjes së vlerës së mbrojtjes së integruar mjedisore.



Projekti do të përmirësojë sistemin e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet përmirësimit teknik të kapaciteteve të personelit të njëjësive vendore për menaxhimin e mbetjeve, si dhe nëpërmjet përmirësimit të njohurive dhe aftësive të studentëve për mbrojtjen e integruar të mjedisit, ekonomisë së qarkullueshme dhe menaxhimit të mbetjeve.



Partnerët e projektit kanë filluar tashmë me aktivitetet e projektit dhe kanë mbajtur një prezantim të përbashkët për media në Guci në muajin qeshor, duke e shfrytëzuar si moment për të nënshkruar një Marrëveshje Partneriteti dhe për të njoftuar opinionin publik rreth aktiviteteve të pritshme.

Aftësi për Punë Shqipëri-Mali i Zi

Me qëllim lehtësimin e aksesit të rinisë dhe grave në tregun e punës, Fondacioni Qendra e Biznesit dhe Strat-Upeve në Tivar në partneritet me Oden Ekonomike të Malit të Zi dhe Agjensinë Shqiptare për Investim dhe Zhvillim (AIDA) po zbatojnë projektin Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse në Zonën Ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi- Aftësi për Punë Shqipëri-Mali i Zi. Vlera e këtij projekti dyvjeçar është 290,000 euro dhe ka për qëllim të rrisë aftësitë profesionale dhe konkurrueshmërinë e personave të papunësuar në zonën ndërkufitare, në mënyrë që plotësohen nevojat e punësimit në sektorin e turizmit, TIK dhe hotelierisë.



Partnerët e këtij projekt, organizuan konferencën e parë mbi mundësitë dhe trendet e punësimit në tregun e punës brënda zonës kufitare, në qytetin e Tivarit. Gjatë kësaj konference u diskutua rreth trendeve të tregut të punës, pengesave dhe mundësive në Shqipëri dhe Mal të Zi si dhe për programet e nxitjes së punësimit për të rinjtë dhe gratë, për aftësitë dhe kompetencat për punësim në të ardhmen dhe mbi qasjen e të rinjve drejt sipërmarrjes.

Realitetet e Reja të Siteve të Trashëgimisë

Projekti Realitetet e Reja të Siteve të Trashëgimisë ka për synim të kontribuojë në zhvillimin e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë së Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe po zbatohet nga Bashkia e Tivarit në bashkëpunim me partnerët shqiptarë Bashkia Tropojë dhe Fondacioni për Autonomi dhe Qeverisje Vendore (FLAG).



Projekti do të zgjasë 30 muaj dhe ka një vlerë prej 533,024.94 euro. Qëllimi specifik i këtij projekti është që të rrisë, bëjë të njohur gjërësisht dhe të promovojë trashëgiminë kulturore ndërkufitare të zonave të Tivarit dhe Tropojës nëpërmjet krijimit të një oferte turistike moderne.

Projekti parashikon restaurimin/revitalizimin dhe adaptimin e siteve të trashëgimisë kulturore të Tivarit dhe Tropojës siç është Qyteti i Vjetër i Tivarit dhe Muzeu i Bajram Currit, si dhe të krijimin të një itinerari të ri turistik dhe një oferte të re turistike nëpërmjet një sistemi të realitetit të shtuar (virtual) i cili do të përfshijë sitin kulturor të Tivarit dhe Tropojës. Si rezultat i këtij projekti janë parashikuar një sërë trajnimesh për grupet e përfshira të interesit nga Tivari dhe Tropoja në fushën e adaptimit dhe ripërdorimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, interpretimit të vendeve të trashëgimisë dhe prezantimit të ofertës së re turistike për popullatën e gjerë. Projekti filloi me aktivitete dhe ndër të parat ishin



organizimi i konferencës së parë dhe nënshkrimi i marrëveshjes së partneritetit ndërmjet partnerëve.

Ndërtojmë Pyje të Zgjuara

Fondacioni për Autonomi dhe Qeversje Vendore (FLAG) nga Shqipëria në partneritet me komunën e Tivarit dhe Bashkinë e Shkodrës po zbatojnë projektin *Ndërtojmë Pyje të Zgjuara*. Në këtë projekt janë parashikuar aktivitete kyçe si krijimi i një plani operacional për instalimin e sensorëve fotovoltaiq për detektimin në kohë të zjarreve si dhe prokurimi, instalimi dhe trajnimi për menaxhimin e teknologjisë së Pyjeve të Zgjuara e cila përdoret për shquarjen e zjarreve të pyjeve.



Gjithashtu, është planifikuar prokurimi i dronëve speciale për monitorimin e rajonit ndërkufitar, instalimi i sistemit të detektimit, si dhe hartimi dhe zbatimi i Planit të Përbashkët për menaxhimin e rrezikut nga zjarret e mëdha dhe mbrojtjen nga zjarri. Poashtu do të mbahen trajnime të posaçme ndërkufitare për të përmirësuar aftësitë e zjarrfikësve për reagim ndaj fatkeqësive natyrore. Përçës kësaj, do të organizohen trajnime për të koordinuar reagimin midis popullatës lokale në zonën

ndërkufitare, ndërsa individë nga popullsia lokale, të cilët do të jenë pjesë e rrjetit të krijuar të vullnetarëve, do të trajnohen dhe pajisen për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore.

Partnerët e këtij projekti kanë filluar tashmë me takime ndërmjet grupeve të interesit ku ndër të tjerë janë Agjencia Kombëtare e Pyjeve të Shqipërisë, OJF lokale dhe Agjencia e Zonave të Mbrojtura.



Kliko [këtu](#) për të parë videon promovues të projektit.

Baseni Ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës - një Rezervat i Biosferës Ndërkufitare

Projekti *Baseni Ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës - një Rezervat i Biosferës Ndërkufitare* po zbatohet nga Qendra për zhvillim, Edukim dhe Bashkëpunim (EDEN), Programi Mjedisor- EnvPro, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nga pala shqiptare si dhe nga Ndërmarrja Publike e Parqeve Nacionale të Malit të Zi. Synimi i këtij projekti është të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së ekosistemit të zonës ndërkufitare, zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të zonës përreth bazenit të Liqenit të Shkodrës dhe promovimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë nëpërmjet harmonizimit sipas kushteve të parashikuara në programin e UNESCO *Njeriu dhe Biosfera* (MAB).



Kohëzgjatja e këtij projekti do të jetë 30 muaj dhe në total do të kushtojë 453,096 euro. Falë objektivave specifike të projektit do të punohet për nxitjen e harmonizimit të përbashkët të kushteve për nominimin e Basenit Ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës si një Rezervat të Biosferës Ndërkufitare (TBR) nga UNESCO dhe në të njëjtën kohë do të përmirësohen qëllimet e biodiversitetit dhe monitorimit të statusit ekologjik dhe rreziqeve të mundshme në terma të UNESCO TBR të mundshëm. Si rezultat i këtij projekti, Mali i Zi dhe Shqipëria do të dorëzojnë formularin e aplikimit për Basenin Ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës (SLW) si një Rezervat i Biosferës Ndërkufitare (TBR) në UNESCO, dhe njëkohësisht palët të interesuara dhe popullsia lokale do të trajnohen për të mbështetur këtë status të mundshëm të, ndërkohë që Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura në Shkodër dhe Zyra e

Parqeve Nacionale në Podgoricë do të paiset në funksion të rritjes së frekuencës së mbrojtjes dhe monitorimit.

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Trashëgimia kulturore - Vepro Mençurë, kurse uji!

Projekti *Trashëgimia Kulturore – Vepro SMART, kurse uji!* implementohet nga Qendra Kosovare për Zhvillim – QKD, Ujësllësi "Bistrica" Sh.PK Bijelo Polje dhe Ujësllësi Rajonal "Hidrodrini" – Sh.A. Pejë. Projekti synon të përmirësojë menaxhimin e burimeve natyrore në zonën ndërkufitare të Malit të Zi dhe Kosovës. Vlera totale e projektit është 523,577.60 euro dhe gjatë 24 muajve të zbatimit, projekti do të rezultojë në përmirësimin e menaxhimit të ujërave në komunat e Pejës dhe Bjelo Polës, si dhe rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimit të popullatës për nevojën dhe rëndësinë e ruajtjes së burimeve ujore. Takimet fillestare dhe konferencat për shtyp janë mbajtur për të shënuar fillimin e aktiviteteve të projektit.



Shikoni videon nga konferenca [këtu](#).

Qasje e Re për Rigjallërimin e Mjedisit - NERA

Komuna e Tuzit, në partneritet me komunën e Pejës, është duke zbatuar projektin *Qasje e Re për Rigjallërimin e Mjedisit – NERA* me vlerë të përgjithshme prej 479,027.23 euro. Gjatë 22 muajve të zbatimit, projekti do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit përmes një qasjeje strategjike të orientuar në komunitetet lokale në Mal të Zi dhe Kosovë. Projekti fokusohet në forcimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë për të krijuar një model efikas të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në këto komuna bazuar në qasjen pjesëmarrëse të qytetarëve. Për të shënuar fillimin e aktiviteteve të projektit u organizua një konferencë për shtyp në komunën e Tuzit më 27 qershor të vitit 2023.



Ndiqui [faqen e projektit](#) për më shumë informacion.

Të rinjtë NEET: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit - "UNEETED"

Me qëllim të përmirësimit të pozitës sociale të të rinjve që nuk janë në arsim, punësim apo trajnim (NEET) në komunat e përzgjedhura në Mal të Zi dhe Kosovë duke rritur punësueshmërinë e tyre dhe duke i lidhur me punëdhënësit potencial, Instituti për Studime Strategjike dhe Prognoza, Instituti për Zhvillim Politika (INDEP), Oda Ekonomike e Malit të Zi dhe Komuna e Mojkovcit po zbatojnë projektin NEET të rinj: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit – "UNEETED". Ky projekt, me vlerë totale prej 206,250.56 euro, ka filluar në mars të vitit 2023 dhe do të zbatohet për 24 muaj. Projekti parashikon zbatimin e një hulumtimi gjithëpërfshirës midis të rinjve NEET me qëllim zhvillimin e politikave

rinore, rritëzimin e të rinjve NEET dhe aktorëve të ndryshëm dhe promovimin e mobilitetit të fuqisë punëtore përmes një platforme të veçantë, si dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive të të rinjve

NEET në komunat e përzgjedhura. Ndërhyrja pilot do të çojë në një rritje të punësueshmërisë dhe punësimit të të rinjve, si dhe në rritjen e kapaciteteve të komuniteteve lokale dhe aktorëve lokalë për të kuptuar nevojat dhe potencialin e të rinjve NEET në mënyrë që të përmirësojnë pozicionin e tyre në shoqëri.

Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës - Pa Kufi!

Projekti *Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës – Pa Kufi!* synon të kontribuojë në rritjen e aftësive dhe kompetencës profesionale të të rinjve dhe grave të papunësuar në rajonin ndërkufitar me qëllim plotësimin e nevojave për punësim në sektorin e turizmit dhe hotelerisë. Projekti me vlerë 262,796.22 euro është duke u zbatuar nga Oda Ekonomike e Malit të Zi, Oda Ekonomike e Republikës së Kosovës, Qendra Rajonale e Biznesit Berane dhe Instituti i Arsimit, Trajnimeve dhe Kërkimeve – ETRI.

Projekti do të mundësojë zhvillimin e aftësive të vetëpunësimit/sipërmarrjes tek të rinjtë dhe gratë në rajonin ndërkufitar në fushën e bujqësisë, gastronomisë dhe zejeve tradicionale. Projekti do të rezultojë në krijimin e një brendi ndërkufitar për promovimin e produkteve dhe shërbimeve vendore, me synim përmirësimin e konkurrencës, promovimin e vetëpunësimit si dhe vendosjen e parakushteve për punësim të mëtejshëm në sektorët prioritarë në rajonin ndërkufitar. Projekti do të zgjasë 24 muaj dhe do të përfshijë 15 komuna.

Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë - UDHËTIMI NË KOHË

Projekti Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë – TIME TRAVEL do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë dhe diversifikimit të

ofertës turistike bazuar në trashëgiminë natyrore dhe kulturore në zonat rurale ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi. Partner kryesor i këtij projekti është Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) nga Kosova, Komuna e Klinës është partner nga pala kosovare, ndërsa partnerë nga pala malazeze janë Qendra për Iniciativat e Turizmit të Qëndrueshëm dhe Organizata Kombëtare e Turizmit e Malit të Zi. Projekti filloi me realizimin e tij në mars të vitit 2023 dhe do të zgjasë dy vjet, ndërsa vlera totale e projektit është 404,235.73 euro. Qëllimi specifik i projektit është të zhvillojë një model njohurish për ruajtjen, vlerësimin, interpretimin dhe integrimin e vendeve të trashëgimisë përgjatë shtigjeve të trashëgimisë natyrore në një ofertë gjithëpërfshirëse të turizmit natyror dhe kulturor dhe t'i promovojë ato së bashku. Kjo do të arrihet përmes formimit të një grupi turistik ndërkufitar që do të lidhë 10 lokalitete të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe Mal të Zi dhe do të jetë pjesë e ofertës tematike turistike "TIME TRAVEL" e cila do të promovohet bashkërisht përmes një fushate marketingu. Shikoni informacionin bazë të projektit në faqen e internetit të Organizates turistike [këtu](#).

TIME TRAVEL

To contribute to improvement of the quality and diversification of the tourism offer building on natural and cultural heritage at cross-border rural areas of KOS and MNE



Quick overview:

Project title: The Cultural Renaissance from Skadar Lake to Kosovo – TIME TRAVEL

Donors: Cross-Border Cooperation Programme Montenegro - Kosovo* 2014-2020 under the Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II)

Project value: 391,000.00 EUR

Implementation period: March 2023 - February 2025

Partners: Community Development Fund (CDF), Centre for Sustainable Tourism Initiatives - CSTI, National Tourism Organisation of Montenegro, Municipality of Kline

Marrëveshja e Gjellbër ndërkufitare

Partneriteti i suksesshëm ndërmjet FORS Malit të Zi dhe Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova), i përforcuar tani me mbështetjen e Komunes së Beranës, vazhdon në fushën e përmirësimit të mbrojtjes së mjedisit në rajonin ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës përmes projektit Marrëveshja e Gjellbër ndërkufitare. Projekti me vlerë 493,683.21 euro, i cili do të zgjasë dy vjet, do të forcojë kapacitetet e institucioneve dhe njerëzve në rajonin ndërkufitar për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe kontrollin e ndotjes së ajrit, duke punuar në të njëjtën kohë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në rajonin ndërkufitar për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe rëndësinë e riciklimit. Rezultatet e pritshme të projektit janë përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe të personelit të kompanive dhe institucioneve mjedisore në rajonin e synuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe kontrollin e ndotjes së ajrit, njohja e tyre me praktikën e mira të BE-së në menaxhimin e mbetjeve të ngurta, ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në nivel lokal dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara në fushën e mjedisit nga Mali i Zi dhe Kosova.

Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore - Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor

Projekti Evokimi dhe Tërheqja e Trashëgimisë Kulturore – Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës ekonomike të zonës duke rritur potencialin kulturor-turistik të zonës. Ky projekt dyvjeçar me vlerë të përgjithshme prej 434,272.10 euro është duke u realizuar nga IP Muzeu i Polimjes në Berane dhe Shoqata Marimangat e Pejës nga Kosova. Projekti synon të kontribuojë në zhvillimin e kulturës dhe turizmit nëpërmjet valorizimit dhe promovimit të përbashkët të trashëgimisë kulturore të kësaj zone, e cila do të nxisë rritjen e numrit të vizitorëve turistikë dhe rritjen e të

ardhurave të komuniteteve lokale. Gjithashtu, projekti fokusohet në aplikimin e mjeteve moderne shkencore për qëllime studimi, konservimi dhe valorizimi, gjë që përmirëson në mënyrë drastike praktikën konvencionale në procesin e ruajtjes dhe promovimit të të mirave kulturore. Gjithashtu, një nga qëllimet e projektit është futja e teknologjisë 3D për përpunimin, ruajtjen dhe prezantimin e të dhënave të përzgjedhura për trashëgiminë kulturore të paluajtshme, duke ofruar kështu një platformë solide për kërkime të mëtejshme, zhvillim dhe ndërjegjësim mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore për shoqëri.

C.L.O.S.E.R. - Mundësi të udhëhequra nga kultura për rivitalizimin e qëndrueshëm ekonomik

Fondacioni i Kosovës për Trashëgimi Kulturor pa Kufij, në partneritet me Komunën e Tivarit po zbaton një projekt dyvjeçar C.L.O.S.E.R. – Mundësi të udhëhequra nga kultura për rivitalizim të qëndrueshëm ekonomik. Vlera totale e projektit është 400,000 euro. Projekti do të përmirësojë mirëqenien e komunitetit në rajonin ndërkufitar përmes krijimit të modeleve të zhvillimit të bazuara në kulturë dhe në të njëjtën kohë, ai përpiket që vlerat ndërkufitare të trashëgimisë kulturore të njihen gjerësisht, të pranohen dhe të promovohen bashkarisht. Rezultatet më domethënëse të pritshme të projektit janë përshtatja dhe vënia në përdorim e objektit të trashëgimisë kulturore në Kosovë që do të përdoret si qendër kreative e Rajonit Ekonomik Perëndimor, si dhe rivitalizimi i rrugëve të vjetra të qytetit të vjetër të Tivarit përfshirë këtu punime pastrimi, shënimi dhe konservime të vogla. Përveç kësaj, aktorët përkatës nga komunat ndërkufitare, duke përfshirë të rinjtë, do të kenë mundësinë të rrisin kapacitetet e tyre në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore, interpretimit të vendeve të trashëgimisë dhe menaxhimit të turizmit.

Kthimi i fshatrave tanë në destinacione turistike

Komuna e Pejës, si partneri udhëheqës, në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal të Lindjes (AZRL) nga Kosova dhe Agjencinë e Zhvillimit Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije, do të zbatojë projektin "Kthimi i fshatrave tanë në destinacione turistike" në dy vitet e ardhshme. Vlera totale e projektit është 456,106.76 EUR, me qëllim kryesor kontribuimin në përmirësimin e shtrirjes, cilësisë dhe dukshëmisë së turizmit me aspektin e valorizimit të trashëgimisë dhe vlerave kulturore dhe natyrore. Qëllimi specifik i projektit është të mbështesë turizmin rural duke zhvilluar ofertën turistike në fshatra, që do të arrihet duke rritur kapacitetet për turizmin rural, si dhe duke zhvilluar dhe promovuar ofertën turistike në fshatra.

Në Punësim, Arsim, Trajnim - IN EET

Me qëllim të kontribimit në përfshirjen sociale të grupeve vulnerable të popullsisë, si dhe qasjen e tyre në tregun e punës, OJQ Juventas nga Mali i Zi dhe OJQ Labyrinth nga Kosova po implementojnë projektin "Në Punësim, Arsim, Trajnim - IN EET".



Nëpërmjet këtij projekti dyvjeçar me një vlerë totale prej 209,448.10 EUR, partnerët do të synojnë të rrisin aftësinë për punësim të të rinjve në grupet në risk duke ofruar shkathtësi konkurruese dhe përvojë pune, duke kontribuar në reintegrimin social të të burgosurve dhe të ish-burgosurve nëpërmjet fuqizimit ekonomik, si dhe duke përfunduar kapacitetet e institucioneve të mbrojtjes sociale në punën me grupet vulnerable. Si rezultat i këtij projekti, të rinjtë në rrezik në të dy vendet do të fuqizohen ekonomikisht dhe do të fitojnë përvojë pune, të ish-burgosurit në të dy vendet do të fitojnë shkathtësi dhe do të kenë qasje



në tregun e punës, ndërsa njëkohësisht politika sociale dhe institucionet e mbrojtjes sociale nga rajoni ndërkufitar do të nxisin bashkëpunimin dhe do të forcojnë shkathtësitë e tyre në zhvillimin e politikave sociale për aktivizimin e përfuturësve final. Partnerët e projektit filluan me aktivitete dhe publikuan thirrjen për interes për të rinjtë për të marrë pjesë në programin e zhvillimit/trajnitimit profesional të paguar që do të zgjasë nga 2 deri në 4 muaj. Pritet që 40 të rinjtë të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë me punëdhënësit të ndryshëm.

Turizmi për të Ardhmen

Projekti dyvjeçar Turizmi për të Ardhmen me një vlerë totale prej 427,507.70 EUR po zbatohet nga OJQ Prishtina REA, si partner kryesor, në bashkëpunim me Shoqatën e Alpinizmit "Đeravica" nga Kosova dhe partnerët malazezë, Komunën e Kolašinës dhe Institutin për Ndërmarrje dhe Zhvillim Ekonomik. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm ndërkufitar nëpërmjet rritjes së prezantimit të çelësit të gjelbër dhe standardeve ekologjike, përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe promovimit të përbashkët.



Nëpërmjet objektivave specifike të tij, projekti synon të rrisë demonstrimin e qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të sistemit eko-turistik në zonën ndërkufitare me fokus në mjedisin, çështjet socio-ekonomike, cilësinë, shëndetin dhe sigurinë, si dhe në standarde dhe kapacitetet në përputhje me etiketat ndërkombëtare eko. Një nga qëllimet specifike është gjithashtu edhe rritja e benefiteve sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal dhe të reduktojë ndikimet negative, në terma të punësimit të popullsisë lokale, mbështetjen e nismave lokale dhe mundësitë për sipërmarrësit lokalë për të përcjellë sistemin e zhvillimit ekologjik. Projekti organizoi konferencën fillestare në Pejë më 31 gusht të vitit, ku u prezantuan aktivitetet e ardhshme.

Promovohet IPA III Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri

Shefja e Sekretariatit të Përbashkët Teknik Sanja Todoroviç, prezantoi IPA III Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri në kuadër të takimit "Dialogu Financiar EUSAIR" që u mbajt në Podgoricë me 20 korrik të vitit 2023. Ky takim bëri bashkë përfaqësues të ministrive malazeze që janë të përfshira në zbatimin e Strategjisë EUSAIR sipas shtyllave tematike, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Çështjeve Europiane të Malit të Zi të cilët janë përgjegjës për koordinimin të IPA-ve kombëtare dhe programeve të bashkëpunimit territorial.



Përparesitë e programeve kombëtare të IPA-ve dhe të programeve të bashkëpunimit territorial përkojnë me objektivat e Strategjisë së BE në Zonën Adriatiko-Joniane (EUSAIR), ndaj u vlerua se është e nevojshme të krijohet një sinerghi më e mirë dhe të zbulohen mundësitë e përgatitjes së projekteve konkrete dhe në kohë.

Strukturat e Programeve IPA-BNK morën pjesë në Forumin Konsultativ Rajonal të CBIB+


Strukturat e IPA Programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë morën pjesë në Forumin Rajonal Konsultativ të bashkëpunimit ndërkufitarë, i organizuar nga CBIB+. Qëllimi i këtij eventi ishte të lehtësonte komunikimin dhe këmbimin e informacionit ndërmjet palëve pjesëmarrëse të Programeve IPA-BNK dhe të promovonte dialogun në lidhje me implementimin e programeve.



Objektivi i Forumin e 9-të ishte të mblidhte komunitetin e Programeve IPA-BNK dhe të inicioj diskutime të lidhura me çështje rajonale. Këto diskutime përfshinin tema të ndryshme, duke përfshirë progresin e programeve IPA II të bashkëpunimit ndërkufitarë, parimet dhe modifikimet e lidhura me IPA III BNK, si dhe të diskutojnë një perspektivë të re mbi strategjitë e komunikimit dhe dukshmërisë, së bashku me tema të tjera të lidhura me programet BNK-së. Eventi mblodhi më shumë se 70 palë pjesëmarrëse nga rajoni.



Gjatë ngjarjes, strukturat operative të të dy programeve patën mundësinë të prezantonin arritjet nën IPA II dhe të ndanin me palët e tjera pjesëmarrëse në rajon sfidat, por edhe praktikatat e mira të përjetuara gjatë implementimit.



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministry
of European Affairs



Montenegro
Ministry of Finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Nersada MANDIJA

Zyrtare Projekti, Antenë
E-mail: nersada.mandija@saspac.gov.al

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53,
Prishtinë, Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



@cbc.mne.alb



@cbc.mne.kos



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian